31|00

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË**
**Nr. 31/00 Vend.**

**V E N D I M**

**PËR REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK**

Në Tiranë, sot më datë 29 / 02 / 2004 (dymije e kater), unë Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë B. Vuna, pasi studiova kërkesën e kërkuesit Imer Babaramo, lindur më 13.03.1961, banues në Gjirokaster, për regjistrim si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"BABARAMO" SHPK** me kapital themeltar 100000(njëqindmijë) lekë dhe afat te ushtrimit te veprimtarise 99 vjet nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar,

**KONSTATOVA SE:**

Kërkesa e kërkuesit **Imer Babaramo**, për regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **" BABARAMO " SHPK me Ortak të Vetem dhe Administrator z. Imer Babaramo, me seli në Gjirokaster, Lagjja "18 Shtatori", me kapital themeltar 100000(njëqindmijë) lekë, me afat te ushtrimit te veprimtarise 99 vjet nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar dhe objekt veprimtarie:**

-Tregetimi, importi dhe eksporti i te gjitha mallrave,produkteve, lendeve te para dhe paisje e makineri,linja prodhimi per perpunimin e lendeve te para te importuara dhe vendase dhe eksport te mallrave te prodhuara;
-Tregtimi, importi dhe eksporti i mallrave, industriale, konfeksioneve, materialeve te ndertimit, atyre elektrike, elektroshtepiake, mallrave ushqimore, si dhe cdo malli tjeter te lejuar nga ligji, me shumice dhe pakice;
-Tregetimi me shumice dhe pakice;
-Trasport mallrash brenda dhe jashte vendit me mjetet e vete shoqerise ose te te treteve.

Është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Në bazë të ligjeve Nr. 7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe Nr. 7667 datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare"

**VENDOSA:**

Regjistrimin si person juridik të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar " **BABARAMO " SHPK, me Ortak të Vetem dhe Administrator z. Imer Babaramo me seli në Gjirokaster, Lagjja "18 Shtatori", me kapital themeltar 100000(njëqindmijë) lekë, me afat te ushtrimit te veprimtarise 99 vjet nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar dhe objekt veprimtarie:**

-Tregetimi, importi dhe eksporti i te gjitha mallrave,produkteve, lendeve te para dhe paisje e makineri,linja prodhimi per perpunimin e lendeve te para te importuara dhe vendase dhe eksport te mallrave te prodhuara;
-Tregtimi, importi dhe eksporti i mallrave, industriale, konfeksioneve, materialeve te ndertimit, atyre elektrike, elektroshtepiake, mallrave ushqimore, si dhe cdo malli tjeter te lejuar nga ligji, me shumice dhe pakice;
-Tregetimi me shumice dhe pakice;
-Trasport mallrash brenda dhe jashte vendit me mjetet e vete shoqerise ose te te treteve.

Të bëhen shënimet përkatëse në regjistrin tregtar.

GJYQTARE

URDHER REGJISTRIMI 31 100

1.1

a) BABARAMO SHPK

b) Lagja 18 shtatori, Gjirokaster

c) Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem, pajisje e makineri, industriale e ushqimore

- Ç) 100.000 leke te derdhura me date 26.01.2004 para Bankes se Kombetare Tregtare Gjirokaster

-

Ortak Imer Babaramo
Administrator Imer Babaramo

Statuti 4 flete

Akti i themelimit 6 flete

Data e nenshkrimit 24.02.2004

Data e regjistrimit 25.02.2004

G J Y Q T A R E
BLERINA MUCA

# AKTI I THEMELIMIT
# I
# SHOQERISË " BABARAMO " SHPK

Sot më dt. 23. 02. 2004 në Tiranë, unë Imer Babaramo, i biri i Musait, i dtl. 13.03.1961, banues në Gjirokaster, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Vendosa si ortak i vetëm, të hartoj dhe nënshkruaj Aktin e Themelimit të mëposhtëm për shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti ë së cilës rregullohet nga statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti themelimi.

**Neni 1**

Emërtimi i shoqërisë është " BABARAMO " SHPK.

**Neni 2**

Selia e shoqërisë është në Gjirokaster, Lagjja "18 Shtatori".

**Neni 3**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është 99 vjet duke filluar nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar.

**Neni 4**

**Objekti** i shoqërisë konsiston në :

-Tregetimi, importi dhe eksporti i te gjitha mallrave,produkteve, lendeve te para dhe paisje e makineri,linja prodhimi per perpunimin e lendeve te para te importuara dhe vendase dhe eksport te mallrave te prodhuara;
-Tregtimi, importi dhe eksporti i mallrave, industriale, konfeksioneve, materialeve te ndertimit, atyre elektrike, elektroshtepiake, mallrave ushqimore, si dhe cdo malli tjeter te lejuar nga ligji, me shumice dhe pakice .
-Tregetimi me shumice dhe pakice.
-Trasport mallrash brenda dhe jashte vendit me mjetet e vete shoqerise ose te te treteve.

**Neni 5**

Administratore e shoqerise do te jete z. Imer BABARAMO.

**Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000(njëqindmijë) lekë, i ndarë në 100 pjesë me vlerë nga 1000(njëmijë) lekë, të cilat i takojnë tërësisht ortakut të vetëm z. Imer Babaramo, i cili është zotërues 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Neni 7**

Shoqëria fillon aktivitetin vetëm pas regjistrimit të saj si person juridik dhe në Regjistrin Tregtar.

**Neni 8**

Shoqëria ka të drejtë të hapë filiale, degë e zyra të saj në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj për ushtrimin e aktivitetit.

Bab

**Neni 9**

Shoqëria do të paiset me dokumentat përkatëse me regjistrimin e saj pranë organit tatimor.

Për veprimtari të veçanta për të cilat legjislacioni kërkon paisjen me liçensa të veçanta, veprimtaria e shoqërisë në këto fusha do të fillojë pas paisjes me këto liçensa.

**Neni 10**

Fitimi që do të rezultojë pas zbritjes së shpenzimeve të aktivitetit të njohura me ligj, pas pagesës së detyrimeve tatimore si dhe shumës që do të jetë rezervë ligjore, do të disponohet nga ortaku i vetëm.

**Neni 11**

Dispozitat dhe rregullat më të detajuara për funksionimin e shoqërisë janë përcaktuar në statutin e shoqërisë bashkangjitur.

**Ortaku i vetëm themelues**

______________________
**Imer Babaramo**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**NR 697 REP NR 59 KOL**

**VËRTETIM**

Sot, më dt. 24 / 02 / 2004, para meje noterit A. Bebero, në zyrën time u paraqit personalisht Imer babaramo, I biri i Mujos, i dtl. 13.03.1961, banues në Gjirokaster, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi i tij personal me numër 1258820, leshuar date 21.10.1998, i cili më deklaroi se Akti i Themelimit i shoqërisë " BABARAMO " SHPK, i redaktuar jashtë kësaj zyre dhe i nënshkruar para meje noterit, shpreh vullnetin e lirë dhe tëplotë të tij. Sa më sipër në bazë të ligjit unë noteri e vërtetoj dhe nënshkruaj.

**NOTERI**

NOTER AFRODITË BEBER

**STATUT**
**I**
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**" BABARAMO " SHPK**

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " BABARAMO " SHPK, është person juridik i themeluar nga ortaku i vetëm Imer Babaramo, i biri i Mujos, i dtl. 13.03.1961, banues në Gjirokaster, me seli te shoqerise Lagjia 18 Shtatori Gjirokaster, me zotësi të plote juridike për të vepruar, e cila e ushtron aktivitetin e saj në mbështetje të ligjit Nr. 7632 dt. 04.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", ligjit Nr. 7638, dt 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare" si dhe ligjit Nr. 7667 dt. 28.01.1993 " Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare ".

**Neni 2**

Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj private në bazë të ekonomisë së tregut të lirë.

**Neni 3**

Ortaku themelues i shoqërisë në këtë sipërmarrje, ka derdhur kapitalin e tij, me qëllim që të përfitojë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin fillestar.

**Neni 4**

Shoqëria " BABARAMO" SHPK është person juridik dhe fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin si person juridik dhe në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë . Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen " BABARAMO" SHPK Gjirokaster.

## EMRI,QENDRA,TERRITORI

**Neni 5**

Emri i shoqërisë është " BABARAMO " SHPK.

**Neni 6**

Selia e shoqërisë është në lagjen 18 Shtatori Gjirokaster dhe e ushtron aktivitetin e saj në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## AFATI I VEPRIMTARISË

**Neni 7**

Afati i kohëzgjatjes së veprimtarisë së shoqërisë është 99 vjet duke filluar nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar.

## OBJEKTI

**Neni 8**

Objekti i shoqërisë konsiston në :

-Tregetimi, importi dhe eksporti i te gjitha mallrave,produkteve, lendeve te para dhe paisje e makineri linja prodhimi per perpunimin e lendeve te para te importuara dhe vendase dhe eksport te mallrave te prodhuara;
-Tregtimi, importi dhe eksporti i mallrave, industriale, konfeksioneve, materialeve te ndertimit, atyre elektrike, elektroshtepiake, mallrave ushqimore,gurit dekorativ e gëlqeres si dhe cdo malli tjeter te lejuar nga ligji, me shumice dhe pakice .
-Tregetimi me shumice dhe pakice.
-Trasport mallrash brenda dhe jashte vendit me mjetet e vete shoqerise ose te te treteve.

**Neni 9**

Ndryshimet në objektin e veprimtarisë si dhe çdo ndryshim tjetër i Aktit të Themelimit dhe statutit bëhet vetëm me vendim të ortakut të vetëm.

**KAPITALI I SHOQËRISË**

**Neni 10**

Kapitali themeltar i shoqërisë " BABARAMO" SHPK është 100.000(njeqindmije) lekë, i ndarë në 100 pjesë me vlerë nga 1000(njëmijë) lekë secila, i marrë përsipër, nënshkruar dhe depozituar nga ortaku i vetëm z. Imer Babaramo.

**Neni 11**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

**Neni 12**

Pjesët e kapitalit themeltar mund t' u trasferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri me akt noterial.

**DREJTIMI ADMINISTRATIV**

**Neni 13**

Administrator i shoqërisë " BABARAMO " SHPK do të jetë z. Imer Babaramo.

**Neni 14**

Administratori ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e shoqërisë . Ai kryen të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

**Neni 15**

Në marrëdhënie me të tretët administratori angazhon shoqërinë nëpërmjet akteve që janënë përputhje me objektin e saj. Në rastet kur administratori është i emëruar nga ortaku i shoqërisë, kryen të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë me perjashtim të atyre që janë kompetencë e ortakut të vetëm.

**Neni 16**

Ortaku themelues i shoqërisë ka kompetencë :

a) Të miratojë programin e shoqërisë, të hartojë raportin e administrimit, inventarët, llogaritë vjetore, të cilat përgatiten brenda afatit 6 mujor duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar;
b) Vendos për shpërbërjen e shoqërisë
c) Vendos për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve
d) Vendos për trasferimin e kuotave
e) Rregullon marrëdhëniet e punësimit e të shpërblimit brenda shoqërisë;
f) Shlyen detyrimet ndaj organeve shtetërore si dhe personave juridikë apo fizik, vendas apo të huaj.

Të gjitha vendimet e rëndësishme për ndryshimet në statut merren me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.

**Neni 17**

Në rast se administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator i zgjedhur posaçërisht nga ortaku themelues, ky i fundit miraton aktet eadministrimit brenda afateve të mësipërme dhe ka të drejtë të informohet
për veprimtarinë e shoqërisë si dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

**Neni 18**

Administratori humbet detyrën e ngarkuar në rast të prishjes së shoqërisë ose kur shkarkohet nga ortaku themelues i shoqërisë.

## MARRËDHËNIET EKONOMIKE FINANCIARE

**Neni 19**

Shoqëria " BABARAMO" SHPK, mund të lidhë kontrata me sektorët shtetërorë, drejtpërdrejt me tregun e lirë si dhe me persona juridikë e fizikë vendas e të huaj.

**Neni 20**

Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqësohet nga administratori ose persona të tjerë të autorizuar prej tij.

**Neni 21**

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë dhe punonjësit e saj.

**Neni 22**

Në bazë të akteve ligjore, shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, sigurimet shoqërore, etj. Sipas legjislacionit të tatimit mbi fitimin, përcaktohen tatimet për veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
Shoqëria ka të drejtë të çelë llogari likujduese pranë bankave në Shqipëri dhe të kryejë veprime financiare me to.

**Neni 23**

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të vetëfinancohet në lekë ose valutë të huaj.

**Neni 24**

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas çmimeve që i cakton vetë shoqëria. Çmimet dhe tarifat do të caktohen sipas kërkesës dhe ofertës së tregut.

**Neni 25**

Për pasqyrimin e aktivitetit tregtar administratori ose persona të tjerë të caktuar prej tij janë të detyruar të mbajnë dokumentacion të rregullt finanaciar dhe regjistrat përkatës konform ligjit.

**Neni 26**

Veprimtaria ekonomike financiare e shoqërisë mbyllet në fund të vitit kalendarik. Administratori është i detyruar të paraqesë bilance periodike, bilancin vjetor së bashku me deklaratën e fitimeve dhe humbjeve dhe t' i depozitojë ato në organin financiar të juridiksionit përkatës ku ushtron veprimtarinë shoqëria.

## MARRËDHENIET E PUNËSIMIT

**Neni 27**

Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë vendos për shtimin ose pakësimin e numrit të ortakëve si dhe për personat e tjerë që do të punësohen në shoqëri.

**Neni 28**

Marrëdheniet e punësimit në shoqëri rregullohen sipas dispozitave ligjore që normojnë veprimtarinë e punës në Republikën e Shqipërisë .

**Neni 29**

Shpërblimi për personat e punësuar në veprimtarinë e shoqërisë " BABARAMO " SHPK caktohen sipas kontratës së punës. Ndryshimi në pagë dhe niveli i pagës vendoset nga ortaku i vetëm.

## BILANCI DHE TË ARDHURAT

**Neni 30**

Të ardhurat neto, pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve të tjera kalojnë në pronësi të ortakut të vetëm të shoqërisë.

**Neni 31**

Shoqëria përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të saj në kapitalin themeltar të shoqërisë.

**Neni 32**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i një viti finaciar të cilit i janë zbritur ose shtuar shumat respektive të humbjeve apo fitimeve të mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 33**

Kur pushon aktiviteti i shoqërisë, kapitali i mbetur, pasi shlyen të gjithadetyrimet, i takon ortakut themelues.

**Neni 34**

Fitimi i mbetur kalon në pronësi të ortakut të vetëm, vetëm pasi janë shlyer të gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundshme për punonjësit e shoqërisë.

## SHPËRBËRJA APO MBYLLJA E SHOQËRISË

**Neni 35**

Shoqëria mbyllet me mbarimin e afatit të përcaktuar në Aktin e Themelimit dhe statut në rast se ortaku i vetëm nuk bën ndryshime në të.

Po kështu ajo mund të mbyllet edhe para afatit duke respektuar të gjitha kërkesat e ligjit 7638 dt 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare ".

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të konstatuara në dokumentet financiare, rezulton më i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku i vetëm vendos brenda 4 muajve nga dita e konstatimit, mbi mundësinë e prishjes sëparakohshme të shoqerisë, në rast se nuk e rregullon këtë gjendje, duke kërkuar në Gjykatë prishjen e saj.

## DISPOZITA TË FUNDIT

**Neni 36**

Shtimi i numrit të ortakëve bëhet me vendim të ortakut të vetëm, i cili ka të drejtën të bëjë ndryshimet e nevojshme në regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

**Neni 37**

Mosmarrëveshjet e shoqërisë në marrëdhënie me persona fizikë e juridikë, vendas a të huaj, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt, kur kjo nuk arrihet, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Tiranë, por shoqëria për probleme që nuk kanë të bëjnë me Regjistrin Tregtar mund t' u drejtohet edhe Gjykates se Rrethit Gjirokastres, të rretheve të tjerë apo të shteteve të tjera.

**Neni 38**

Për sa nuk është shprehur në këtë statut dotë zbatohet ligji Nr. 7638, dt.19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare " si dhe legjislacioni shqiptar ns tërësi që normon këtë veprimtari.

U nënshkrua në Tiran[ sot më dt. 23.02.2004

**ORTAKU I VETËM THEMELUES**

**Imer Babaramo**

*Babaramo* [signature]

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERËVE TIRANË**
**NR** 697 **REP NR** 59 **KOL**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**NR** 697 **REP NR** 59 **KOL**

**VËRTETIM**

Sot më dt.24 / 02 / 2004, para meje noterit [signature], në zyrën time u paraqit personalisht Imer Babaramo, I biri I Mujos, i dtl. 13. 03.. 1961 lindur

dhe banues ne Gjirokaster, me zotësi të plotëjuridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi i tij personal me numër 1258820 l[shuar dat[ 21.10.1998, i cili më deklaroi se statuti i shoqërisë "BABARAMO" SHPK, i redaktuar jashtë kësaj zyre dhe i nënshkruar para meje noterit, shpreh vullnetin e lirë dhe të plotë të tij. Sa më sipër në bazë të ligjit unë noteri e vërtetoj dhe nënshkruaj.

NOTERI

NOTER
AFRODHITI GJEBER

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERËVE TIRANË**
**Nr.** 696 **Rep**

**VËRTETIM**

Në Tiranë, sot më datë 24 / 12 / 2004 para meje noterit ______________, u paraqit personalisht

Imer Babaramo,i biri Mujos, dtl.13.03.1961, banues ne Gjirokaster, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me dokument identifikimi nr.1258820 lëshuar dt 21.10.1998:

i cili më kërkoi vërtetimin e nënshkrimit të tij në këtë kërkesë dhe unë noteri pasi u binda për identitetin e tij nga dokumenti i identifikimit e vërtetoj atë sipas ligjit.

**NOTERI**

**KËRKESË**

| | |
|---|---|
| KËRKUES: | Imer Babaramo, i biri i Mujos, i dtl.13.03.1961, banues ne Gjirokaster, me zotesi te plote per te vepruar, me numer pasaporte 1258820 |
| OBJEKTI: | Kërkohet të bëhet regjistrimi i shoqërisë "BABARAMO" SHPK si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. |
| BAZA LIGJORE: | Ligji Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Për shoqërite tregtare" dhe ligji Nr.7667, dt.28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare" |

**GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË**

Une Imer Babaramo, i biri i Mujos, i dtl. 13.03.1961, banues ne Gjirokaster, ne cilesine e ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "BABARAMO" SHPK, te themeluar nga unë ortaku i vetem Imer Babaramo, me seli ne Gjirokaster, Lagjja "18 Shtatori", me kapital themeltar 100000 leke, afat te ushtrimit te aktivitetit te saj 99 vjet nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar dhe objekt te veprimtarise :

-Tregetimi, importi dhe eksporti i te gjitha mallrave,produkteve, lendeve te para dhe paisje e makineri,linja prodhimi per perpunimin e lendeve te para te importuara dhe vendase dhe eksport te mallrave te prodhuara;
-Tregtimi, importi dhe eksporti i mallrave industriale, konfeksioneve, materialeve te ndertimit, atyre elektrike, elektroshtepiake, mallrave ushqimore, si dhe cdo malli tjeter te lejuar nga ligji, me shumice dhe pakice .
-Tregetimi me shumice dhe pakice.
-Trasport mallrash brenda dhe jashte vendit me mjetet e vete shoqerise ose te te treteve.

Ne mbeshtetje te dispozitave ligjore perkatese kërkoj regjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " ALAN " SHPK si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

**IMER BABARAMO**

**ADMINISTRATOR**

BANKA e TIRANES
TIRANA BANK

2678

Branch: 0400 Dega GJIROKASTER
18 SHTATORI
GJIROKASTER
Tel: 00355-726-4125
SHQIPERI

BABARAMO YMER

LAGJIA 18 SHTATORI
GJIROKASTER
ALBANIA

| | |
|---|---|
| Data | 16SHK04 |
| Tipi i Deal-it | Depoz.Escrow Deri ne 1 Muaj |
| Monedha | Lek |
| Refer.Llogarise | E1MB/G'TEE4/4004 |
| Statusi | DEAL IRI/MODIFIK.SOT |

## K O N F I R M I M I I D E P O Z I T E S K O L A T E R A L

Konfirmojme depoziten e mbajtur si kolateral si me poshte

| | | |
|---|---|---|
| Shuma e depozites kolateral | | ALL 100,000.00 |
| Fillimi-Maturimi | 17SHK04-OPEN | |
| Perqindja e interesit | 0.0 | |
| Taksa e interesit% | 0.0 | |
| Ditet e inter./Baza | 0/365 | |
| Shuma totale interesit | | ALL 0.00 |
| Shuma totale e takses | | ALL 0.00 |
| Shuma neto e interesit | | ALL 0.00 |

Ne fillim

Ne maturim
0400 B/G'TEE 4/4004
NGURTESIM PER NXJERRJE LICENCE NGA
SHOQERIA "BABARAMO" SHPK ME
PERFAQESUES YMER BABARAMO

TIRANA BANK S.A.
GJIROKASTER

Firma(t) e Autorizuar(a)

30031/1M/05-00

TIRANA BANK

Tirana Bank S.A.
Dëshmorët e Kombit 55/1
Tirana, Albania
Tel.: (00355 4) 233 441
233 482, 233 447
Fax: (00355 4) 233 417

**BANK GUARANTEE. No 4/4004 dt 16.02.2004**

**Drejtuar: GJYKATA E RRETHIT TIRANE .**

Me kete dokument vertetojme se**"BABARAMO" SHPK** me perfaqesues **Z. BABARAMO YMER** ka derdhur prane **"BANKES SE TIRANES" Sh.a., Dega Gjirokaster,** shumen prej **100.000 ( Njeqind mije leke vetem)** si kusht per nxjerrje licence nga" **BABARAMO " shpk.**

Banka merr persiper te kaloje ne llogarine e perfituesit shumen qe i korrespondon kesaj Garancie Bankare ne rast se:

1.Perfundon afati I nxjerrjes se lishences ose para afatit vetem me kerkese te subjektit dhe miratim te Gjykates se Rrethit TIRANE.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne plotesimin e dokumentacionit ligjor te nevojshem per marrjen e lishences per krijimin e subjektit privat te lartpermendur.

Me mbarimin e ketij afati, origjinali i Garancise Bankare duhet te kthehet ne Banke, pasi kjo behet e pavlefshme.

**BANKA E TIRANES SH.A**

**Mirela QURKU**

**N/DREJTOR**

**Brunilda DHAMI**

**PUNONJESE OPERACIONALE**

**TIRANA BANK, GJIROKASTER BRANCH**
**Rr "STUDENTI", Gjirokaster**